



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tridhjetë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **25.09.2024**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- | | |
|--------------------------------------|------------------------------------|
| 1. <u>Enver Rugova, LDK;</u> | 14. <u>Ardita Idrizaj, AAK;</u> |
| 2. <u>Hajrush Shoshi, LDK;</u> | 15. <u>Negjdet Ramaj, AAK;</u> |
| 3. <u>Faruk Kabashi, LDK;</u> | 16. <u>Nexhmedin Balaj AAK;</u> |
| 4. <u>Haki Podrimaj, LDK;</u> | 17. <u>Fjolla Ukaj, AAK;</u> |
| 5. <u>Faik Alushaj, LDK;</u> | 18. <u>Niman Beqiraj, VV;</u> |
| 6. <u>Veton Kurtaj, LDK;</u> | 19. <u>Floriana Maxharraj, VV;</u> |
| 7. <u>Arta Balaj, LDK;</u> | 20. <u>Lavdije Bujupaj, VV;</u> |
| 8. <u>Liridona Lajci Avdijaj LDK</u> | 21. <u>Arian Shatri VV;</u> |
| 9. <u>Valbona Demaj, LDK;</u> | 22. <u>Visar Haxhijaj, PDK;</u> |
| 10. <u>Ruzhdi Metaj, LDK;</u> | 23. <u>Andi Xhuraj PDK;</u> |
| 11. <u>Njomza Demaj, LDK;</u> | 24. <u>Era Visoqi, PDK;</u> |
| 12. <u>Arianit Selmanaj, LDK;</u> | 25. <u>Melis Smakic;</u> |
| 13. <u>Agron Gashi, AAK;</u> | |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, Nënkryetari i komunës Ali Nimanaj, Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ, OSBE si dhe media lokale RTV – Fontana (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

<https://www.youtube.com/watch?v=RyXG4igY7IA>

"shembulli 3").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit– përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e tridhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezent janë 25 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit 2025-2027,
4. Caktimi i lokacionit për ndërtimin e deponisë së materialeve inerte në Tuqep,
5. Caktimi i lokacionit për ndërtimin e transfer deponisë,
6. Plotësim ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha,
7. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 110 të datës 30.07.2024,
8. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr.113 të datës 30.07.2024,
9. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- në bazë të kërkesës që e kemi nga i autorizuari i familjes së heroit kombëtar Selman Kadria, propozoj që të hyn në rend dite 'caktimi i lokacionit për ndërtimin e shtatores së heroit Selman Kadria në Istog, për shkak të disa mungesave teknike nuk ka mundur të hyn kjo pikë në Komitetin për Politikë dhe Financa, e propozoj këtë pikë që të hyn në rendin e ditës për mbledhjen e sotme. Për një arsyetim më të thukët fjalën e ka kryetari i komunës.

Kryetari i Komunës- përshëndet të gjithë të pranishmit! Pas diskutimeve të shumta që i kemi pasur me përfaqësuesin e autorizuar të familjes z. Gëzim Muriqi që njëhersh është edhe skulptori i shtatores së heroit kombëtar Selman Kadria, si dhe me familjarë konkretisht Agron Hasanin që është qytetar i Istogut dhe jeton në SHBA pas hulumtimit prej anës së tyre edhe në dakordim edhe prej nesh si ekzekutiv është propozuar që lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit kombëtar Selman Kadria të jetë te parcela te shtëpia e Kulturës. Çka arrijmë ne prej marrjes së pëlqimit nga ana e Kuvendit është që e caktojmë lokacionin te shtëpia e Kulturës dhe pastaj bashkërisht me përfaqësuesit e autorizuar dhe familjarin e caktojmë saktë lokacionin se ku brenda

asaj parcele ka me u vendosur shtatorja. Duhet pasur parasysh që parcela është e përcaktuar edhe me Hartë Zonale si zonë kulturore e cila na lejon dhe na jep të drejtën ligjore me e vendosur shtatoren. Kur vijmë te kjo pikë drejtori i Urbanizimit do të jap detaje të tjera. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- edhe unë kam biseduar me Agronin edhe me njerëz të fushës që shtatorja e Selman Kadrisë më së mirë është të vendoset në Parkun e qytetit, konsideroj që te shtëpia e Kulturës është një vend i fshehur, nuk frekuentohet prej qytetarëve dhe besoj që Selman Kadria e meriton në shesh e jo në skuta të qytetit, besoj që shumica e anëtarëve të Kuvendit pajtohen me këtë dhe kisha propozuar që me e përkrahur edhe ne si anëtarë të Kuvendit një vend më të dinjitetshëm e ai kishte me qenë Parku i qytetit. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës

Kryetari i Komunës- shtëpia e Kulturës nuk është skutë e ka emrin “Adem Jashari” nuk është e fshehtë dhe është pranë rrugës kryesore, dhe është propozim që nuk e kam shpikuar unë, po e kam marrë prej përfaqësuesit të autorizuar të familjes i cili është edhe skulptor Gëzim Muriqi edhe ne dakordim ose me kërkesë të Agron Hasanaj që është familjar i heroit. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- vetëm desha ta di çfarë po na pengon me e qit në park të qytetit? Unë nuk po kërkoj me e emëruar parkun “Selman Kadria” vetëm po kërkoj që shtatorja e heroit të vendoset në park të qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- ne si grup i Lëvizjes Vetëvendosje e përkrahim propozimin për lokacionin që e propozoi Negjdet Ramaj.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetari e ka fjalën.

Kryetari i Komunës- ta di a po mundemi ta kemi të qartë, është propozim i përfaqësuesit të autorizuar dhe të familjarit, nuk është fontantë dëshirash e partive politike këtu.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- në emër të grupit edhe pasi po e shohim si kërkesë, nuk është diçka e keqe me debatuar, vend me të mirë se parku i qytetit nuk ka, nuk është propozim i keq, kryesues mundesh me hedh edhe në votim ta shohim sa ka përkrahje, e tha edhe

Negjdeti shtëpia e Kulturës është pak e fshehtë për vizitorë me e parë një hero të Istogut.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- këtu po thotë që është vendim për caktimin e lokacionit dhe është e dhënë edhe zona kadastrale, ne nuk po japim pëlqim po po e caktojmë vendin, pra me qenë me të qartë me ditë edhe të tjerët se çfarë po votojmë. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- propozim vendim është, defekt i imi ju kërkoj falje. A ka edhe dikush diçka në lidhje me rendin e ditës? Naim Behlulaj e ka fjalën.

Naim Behlulaj- pëshëndet të gjithë të pranishmit! Kërkoj që në rend dite të futet pika 'formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore për shkak se mandati i tyre ka përfunduar në muajin e tetë. Kemi konkurse të hapur për drejtorë dhe duhet të formohet komisioni i ri. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- a ka edhe dikush diçka tjetër? Pasi që jo i hedh në votim këto propozime që të hyn në rend të ditës. E hedh në votim propozimin e kryesuesit të Kuvendit, kush është të hyn në rend dite 'caktimi i lokacionit për ndërtimin e shtatores së heroit Selman Kadria në Istog?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim votohet që kjo pikë të hyn në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

E hedhim në votim edhe propozimin e drejtorit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore në komunën e Istogut? Kush është për?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim votohet që kjo pikë të hyn në rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh ne votim rendin e ditës në terësi me dy propozimet e votuara? Kush është që të procedojmë me këtë rend dite për mbledhjen e sotme?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet rendi ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje janë të pranishëm 25 anëtarë të Kuvendit, mungojnë Ajshe Metaj dhe Florin Dreshaj.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? A ka dikush vërejtje apo sugjerime? Pasi që jo, e hedh në votim kush është që të miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar?

Konstatojmë që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 25 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit- tani e kemi një pikë me të rëndësishmen që e shqyrton dhe miraton ky Kuvend. Fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- diskuton në lidhje me pikën e rendit të ditës. Dhe për një sqarim më tutje fton drejtorin Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit 2025-2027.

Kryesuesi i Kuvendit- e kam një kërkesë nga anëtari i Komitetit për Komunitete, pra një listë për me i propozuar këtu para Kuvendit. Fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- është zyra për Komunitete dhe Kthim ku mund t'i adresojnë kërkesat e tyre për projekte e të cilat janë edhe pjesë e këtij buxheti që kanë ardhur konkretisht nga kjo zyrë si propozime në fshatrat apo lagjet ku ka komunitet pakicë. Janë afatet kohore ku munden me i adresuar këto propozime. E gjitha jo që mund të bëjmë është t'i bëjmë pjesë të kësaj tablele pastaj është pjesë e listës me prioritet që publikohen në faqen e komunës e pastaj mund të përfshihen në vitet në vijim. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- kjo në një lloj forme është me të vënë para aktit të kryer dhe me tentuar me devijuar komplet buxhetin. Për çka janë dëgjimet publike, për çfarë po i bëjmë ato? Kanë mundur të vijnë në dëgjime buxhetore, i bëjmë pjesë të tabelës prej burimve të pasigurta.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- më intëresoi parku pushues dhe rekreativ në Rakosh e kemi diskutuar shumë herë, nuk figuron askund. Desha të di se çfarë ka ndodhur me atë projekt. Dhe për rrethrotullimin në Shushicë të Ulët, ka qenë si propozim por nuk figuron as ky askund. Dhe e kam një kërkesë për rrugë të bjeshkës, pasi që Vrella dhe Banja përfshihen në rrugën për Lug të Butë së fundmi do të asfaltohet edhe rruga për Moknë, mirëpo e kam një propozim që edhe zona e mbi vadës mos të mbetet anash në këtë aspekt. Dhe e kisha propozuar rrugën Uçë-Vojdullë-Moknë të asfaltohet në të ardhmen, le të jetë si projekt. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Agron Gashi.

Agron Gashi- diskuton në lidhje me pikën e rendit të ditës. E kam parë këtë Buxhet dhe nuk po lëshohem në projekte të caktuara. Desha të ndalem pak te premtimet që i ka bërë kualicioni sepse nuk po i shohim në buxhete vit pas viti. Desha të ndalem te turizimi, te ekonomia, te arsimit edhe te bujqësia, po e shoh që edhe këtë mandat nuk ka zgjidhje për fëmijët në çerdhe, kryetari ka premtuar që çdo fëmijë i Istogut ka me pasur vend në çerdhe, nuk është zhvilluar kjo pjesë e arsimit që e ka premtuar kryetari. Pastaj te pjesa e ekonomisë është komplet dështim pjesa e investimeve, e punësimit dhe pjesët tjera që i ka premtuar kryetari, ka premtuar mbi 60 start-up-e të cilat nuk janë askund sot, ka premtuar që 200 ekonomi familjare kanë me pasur subvencione, ka premtuar me i liruar nga pagesa gratë dhe sipërmarrësit e rinjë nuk ka asgjë, ka premtuar me i subvencionuar gratë që lindin fëmijë 250.00 euro-150.00 euro por nuk ka asgjë as këtu. Edhe pjesa e bujqësisë ka pasur mangësi të mëdha, pjesa e lumenjëve, e shtratit të lumit, është pjesa e pyjeve që nuk ju keni bërë zgjidhje. Si dhe pjesa e sportit që e keni lënë anash në këtë mandat, gjithashtu edhe rininë, kështu që në çështje të përgjithshme jam shumë skeptik dhe i pakënaqur me këtë qeverisje dhe këto buxhete që po i sjellni me i votuar. Faleminderit!

Kryetari i Komunës- jep përgjigje dhe sqarime. Negjdet parku në Rakosh është në procedurë njëherë. Oferta ka ardhur mbi planifikim diku 60% për shkak të një kompanie të papërgjegjshme. Edhe pse nuk është në buxhet ne jemi në negociata me kforin Italian të cilët kanë premtuar që do ta marrin përsipër investimin në parkun në Rakosh. Sa i përket rrethrotullimit, është çështje që i përket ministrisë së Ambientit. Uçë-Vojdullë-Moknë pajtohem me pasur kod buxhetor pej burimeve të pasigurta të financimit që me pasur pastaj mundësi që përmes ministrive të linjës ose donatorëve me trajtuar si zonë. Agron, diskutimi po tregon që i kemi zgjedhjet afër. Çerdhe, konkretisht me ministren Nagavci i kam zhvilluar tri takime veç me arrit me e shkëputur kontratën për ndërtimin e çerdhes në Istog. Për tri vjet ministria e arsimit nuk ka mundur ta shkëpus atë kontratë. Është shpallur procedura e prokurimit prej ministrisë prapë pasi që e kemi dërguar ne projektin për çerdhe në fshatin Gurrakoc minsitria i ka planifikuar 700 mijë euro, e ka shpallur procedurën pas ankesave të operatorëve e kanë anuluar. Te ekonomia konsideroj që duhet të marrësh informacione pak

më shumë. E shoh që janë më shumë se 60 start-up-e që janë përkrahur e shoh që janë më shumë se 300 ekonomi familjare që janë përkrahur që hyn në bujqësi, në turizëm. Lirimi nga pagesa e lindjeve besoj që janë të planifikuara për vitin e ardhshëm. pjesa e buqësisë është trajtuar me hartë zonale për bujqësi, është trajtuar me solare, me sera, me fidanë, me kanale të ujitjes. Pjesa e shtratit të lumit dhe e kolektorëve kryesorë është projekt që kap shifrën 14-15 milionë euro. Pyjet nuk janë pa zot, deri këtë vit ne e kemi menaxhuar pjesën e pylltarëve përmes drejtorisë së bujqësisë, tani e tutje i menaxhon Agjencioni i pyjeve. Nuk ka prerje aq enorme, marrim raporte në baza mujore. Te pjesa e rinisë ka aktivitete përmes drejtorisë së Kulturës.

Ardita Idrizaj- te ndërtimi i trotuarit Lubozhdë-Vrellë, propozoj edhe ndriçimin, te ndërtimi i rrugëve në Lubozhdë lagjia "Osaj" dhe "Pepaj" propozoj edhe rrugën "Ledinat" poashtu propozoj t'i ndihmoni gratë që udhëheqin bizneset e tyre to vogla.

Kryesuesi i Kuvendit- Fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- i kam disa propozime që duhej të ishin të përfshira në këtë draft Buxhet. Subvencionimi i nënave lehona, subvencionimi i pagesës së çerdhes private nga prindërit vetushqyes, subvencionimi me qira për gratë që merren me punë artizanale si dhe të krijohet një fond i veçantë për klubet sportive të cilat marrin pjesë në garat ndërkombëtare. Po ashtu e kam një pyetje edhe për drejtorin e DKA-së a janë të angazhuar këshilltarët e karrierës në Istog siç është e specifikuar në një udhëzim administrativ që e ka bërë Ministria e Arsimit e cila është 18/2023. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- përgjigjet në pyetje dhe jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit-faleminderit drejtor! Fjalën e ka Haki Podrimaj.

Haki Podrimaj- diskuton rreth pikës së rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- askund nuk ka ndonjë planifikim për pagesën e kontratave kolektive. P.sh vetëm 4% janë ndarë për komplet Kulturën Rininë dhe Sportin e qytetit duke i përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike, poashtu 4% janë ndarë edhe për Bujqësinë, për të gjitha kategoritë siç e quajta më herët. Nuk ka projekte për turizimin. "Bukuroshja e Ballkanit" ka qenë projekt milionësh por gjithmonë është diku në fund në pjesën ku nuk ka burime të sigurta të financimit. Në Kornizën Afatmesme Buxhetore ne si anëtarë të Kuvendit nga Lëvizja Vetëvendosje veçmas kemi kërkuar projektet tona të jenë pjesë e këtij buxheti në mënyrë që edhe ne t'i përkrahim dhe të vazhdojmë tutje. Ka qenë subvencionimi

i nënave lehona që e përmendi edhe drejtori që paskan bërë zgjidhje, po unë dua ta di në cilën drejtori e keni lënë atë buxhet? Te subvencionimi i pagesave për çerdhe për nënat vetushqyese, subvencionimin e qirave për grate artizanale, projektin e Moknës, ndërtimin e një deponie për materiale të ngurta inerte, e kam parë që është në rend dite caktimi i lokacionit por çështja e financimit nuk është e paraqitur. Kemi kërkuar ndarjen e dy kodeve buxhetore për dy drejtori në mënyrë që me pasur sa më shumë transparencë buxhetore, kemi kërkuar rregullimin e qendrës së Vrellës, kemi kërkuar ndërtimin e parkingut për varreza në Vrellë, gjithashtu edhe shtrimin e një rruge nga vendi i varrimit deri tek vendi ku ka me u varrosur kufoma. Pastaj ka qenë rregullimi i infrastrukturës për burimin e Vrellës dhe vazhdimin e punimeve në sallën e sporteve në Vrellë, kemi kërkuar subvencionimin e të gjithë fermerëve së paku me 8 cent për litër të qumështit, krijimi i një fondi për start-up bizneset për të rinjtë dhe gratë ndërmarrëse, betonimin e vijës së Potokut, kemi kërkuar 5-fish të shumës për subvencionime dhe transfere për mjetet dhe makineritë bujqësore, kemi kërkuar krijimin e një fondi të veçantë për ndihmë për kafshët që i humbin bujqit si pasojë e dëmtimeve apo sëmundjeve, kemi kërkuar rritjen e fondit për kulturë rini dhe sport nga 60 mijë në 100 mijë euro, kemi kërkuar një fond të veçantë për klubet sportive që marrin pjesë në garat ndërkombëtare, kemi kërkuar asfaltimin e rrugës "Spanja" në fshatin Dubravë, kemi kërkuar ndërtimin e dy urave në fshatin Kovragë, kemi kërkuar pastrimin e lumit "Shushica" kemi kërkuar edhe riparimin e shkollës "Bajram Curri" në Cerrcë. Në qoftë se disa prej këtyre propozimeve ose të gjitha përkrahen ne jemi të gatshëm edhe me votuar edhe me qëndruar afër nëse është e nevojshme. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- Pjesën e përmbauesit nuk po dua ta diskutoj sepse e diskuton drejtori. Të gjitha këto që i përmende Niman në bazë të përvojës në Kuvendin e Kosovës e di se si i merrni, ata që i shkruajnë nuk e njohin Istogun. Ju kisha lutur të merreni me terren edhe e kishit parë realizimin e secilit projekt. Keni pasur mundësi të bëheni pjesë e planifikimit nuk ju kemi faj ne. Sporti, i përmenda më herët nuk po dua të t'i përsëris më. Pjesa e "Bukuroshës së Ballkanit" është mirë me e kuptuar fjalën projekt dhe projekcion buxhetor. Është mirë me i kuptuar fazat, e me ju gëzuar atyre fazave. Janë punë shumë të mëdha që janë realizuar e që po tentohet të japin si të papërfunduara, e kuptoj politikbërjen, por nuk duhet të shrembërohen faktet. Buxheti në asamblë nuk amandamentohet, amandamentohet në Kuvend të Kosovës, mundesh të propozosh por jo të amandamentosh. Varrezat e reja në fshatin Vrellë, me erdh shqetësuese se si ti e definon një projekt që është i mirë. Një projekt që është realizuar në një territor jo bash të përshtatshëm dhe me një kosto goxha të madhe, dhe që është ardhur si propozim prej njerëzve që janë përfaqësues të fshatit Vrellë. Vrella e din Niman por ti jo, që për vitin e ardhshëm i ka të planifikuara 460 mijë euro. Pjesa e trajtimit të bujqësisë, fermerët në Istog janë gjigand. Jemi komuna numër një për prodhim të qumështit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- Floriana, jemi komuna e parë që e kemi këshilltarin e karrierës në shkollën “Bajram Curri” është 6-9 që e kemi të lejuar si kuotë. Ndërsa 1-5 nuk e kemi të lejuar, presim këtë vit të lejohet. Niman rinovimi në Cerrcë aty e kemi vetëm vendin ku është kaldaja që është djeguar nga një fatkeqësi prej rrymës në muajin maj, ka filluar puna që të mbulohet ajo pjesë. Ndërsa në shkollën “Bajram Curri” nuk pajtohem me ty, nuk ka qenë gjendja aq alarmante. Sot ka shkuar punëkryesi me i marrë masat deri të hënën do të bëhet rinovimi i të gjitha atyre klasëve që kanë pasur lagështi.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- Te pjesa e përmbaruesit që e diskutove Niman, nuk ka planifikim të kontratës kolektive e kam sqaruar shumë herë. Komuna e Istogut nuk e ka asnjë përgjegjësi në lidhje me kontratat kolektive. Kontrata është një sfidë për komunën e që këtë vit fatkeqësisht ministri jonë i Financave po e aplikon që drejtpërdrejtë me i dëmtuar komunat. Nuk dëmtohet qytetari për inate politike.

Kryesuesi i Kuvendit- replikë Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- njëherë e kam me kryetarin. Ajo çka e fole ti kryetar për projektet edhe buxhetin edhe ato çfarë janë në praktikë të ndërtuara si projekte është diskrepancë e madhe. Unë të sfidoj cilëndo sallë të sportit me shku me luajtur futboll, përmende, thuaj këtu mundemi të shkojmë. Sa I përket buxhetit të ndarë për Vrellën, çdo vit po ndan, po nuk është duke u bërë asgjë. Te shkolla “Bajram Curri” një replikë për drejtorin e Arsimit, unë i kam postuar në Facebook shkrimet që më kanë ardhur prej qytetarëve. Si dhe me drejtorin e Buxhetit, unë edhe i gjithë grupi i asambleistëve kemi qenë shumë konstruktiv kurrë nuk kemi votuar diçka kundër në qoftë se nuk kemi pasur se çfarë të themi. Unë nuk kam faj pse ju ka mbetur prej qeverisjeve të kaluara ky borxhi i kontratave kolektive, kjo ka dalë në Gjykatë, dhe e ka marrë një vendim. Te rruga “Haki Hoti” qëllimshëm nuk e përmenda sepse e di që ka filluar.

Kryesuesi i Kuvendit- replikë drejtori Genc Ademaj.

Genc Ademaj- Raporti i Auditorit nuk e ka specifikuar se komuna i ka fajet. Por shpenzim që ka ndodhur që ata e dinë mirë shumë edhe nuk kanë dhënë raport të kualifikuar. Ka qenë një raport i shkëlqyer edhe që kemi me ja parë hajrin këtë vit ne edhe qytetarët, e atë po e bëjmë bashkë me ju.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Naim Behlulaj- jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj

Floriana Maxharraj- Te këshilltarët e karrierës me sa e kam lexuar udhëzimin administrativ këshilltarët janë për shkollat e mesme të ulëta dhe shkollat e mesme të larta. Mirë që qenka një në shkollën fillore “Bajram Curri” por a ka tendenca që të rritet numri i këtyre këshilltarëve, dhe a mundeni me na treguar diçka çfarë keni me bërë për dixhitalizimin nëpër shkolla.

Naim Behlulaj- përgjigjet në pyetje dhe jep sqarime.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- e pata një reagim për Nimanin te puna e investimeve me theks të veçantë në Vrellë ku vlera është 460 mijë euro, por duhet me u rikthyer edhe pak pas, Lëvizja Vetëvendosje e ka votuar këtu kundër buxhetin e vitit të kaluar. Edhe për palestrën në Vrellë që i kemi ndarë mjetet ti ke votuar kundër Niman. Jep sqarime tjera.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- mirë që foli drejtori, mirëpo unë edhe njëherë po ta bëj pyetjen, paret kanë shkuar, qenka miratuar buxheti prej teje vitin e kaluar, projektet ku janë? Ku është salla e sportit, ku është projekti, ku është burimi? Një projekt që e ka financuar qeveria ka qenë Lugu i Butë.

Kryesuesi i Kuvendit- edhe ne nuk po kemi mjete mjaftë, nuk kërkuat pak me shtuar buxhetin e Kuvendit për mallra dhe shërbime që është numër një, dhe numër dy nuk kërkon nga kryetari me e rregulluar sallën e Kuvendit. Fjalën e ka Valbone Demaj.

Valbone Demaj- në bazë të kërkesave që dolën nga kolegët, po e shoh që nuk kanë qenë pjesë e dëgjimit publik që është mbajtur dy ditë radhazi, ka pasur qytetarë, OJQ, shoqëria civile, përfaqësues të klubeve sportive, nxënës të shkollave të mesme që i kanë adresuar kërkesat e tyre në mënyrën më të mire të mundshme

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha të ndërlihem me Agonin. 460 mijë euro për Vrellë, e bashkësia lokale e Rakoshit mos me qenë në gjendje një park me ndërtuar, edhe pse kemi përfaqësues, ish dashur me i ngulë këmbët pak më shumë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka nënkryetari i Komunës.

Nënkryetari i Komunës- ndoshta dikush gjen forma të ndryshme me komunikuar me publikun, por personalisht jam çdo ditë në terren, edhe tash kur po flasim për buxhet e ke parë që pjesa e mbi vadës është e trajtuar mirë, konsiderueshëm. Jo ashtu siç kishim dashur të gjithë ne që vijmë nga ai lokalitet. U përmend parku, e kemi hartuar projektin është proceduar, por oferta e operatorit ekonomik ka qenë më e madhe, në raport me atë pjesën e planifikimit buxhetor sa ka qenë. Jep sqarime të tjera.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- desha ta di këto propozime që i dhashë a futen në projekt buxhet, desha ta di se çfarë po votojmë.

Genc Ademaj- po Negjdet bëhen pjesë e listës prej burimeve të pasigurta, d.m.th hyn.

Kryesuesi i Kuvendit- kush është që të votohet Buxheti për vitin 2025?

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota për 5 kundër dhe 0 abstenim miratohet Buxheti për vitin 2025.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Abedin Kabashi.

Abedin Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës 'Caktimi i lokacionit për ndërtimin e deponisë së materialeve inerte në Tuqep.

Kryesuesi i Kuvendit- e hapim debatin, fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- te sipërfaqja prej 2300 m² apo 23 ari po më duket është shumë pak, e jap propozimin që të ngritet një një hektar së paku.

Abedin Kabashi- në konsultim me GIZ-in dhe me organizatat tjera ideja është që të caktohet lokacioni e pastaj të zgjerohet mendoj që për fillim dy hektarë janë mjaft.

Hajrush Shoshi- jo është 2300 m².

Abedin Kabashi- atëherë është gabim teknik, se 23000 m² janë.

Kryesuesi i Kuvendit- është gabim teknik, pra janë 23000 m² faleminderit Hajrush për korrigjimin. A dëshiron edhe dikush diçka? Pasi që jo, atëherë e hedh në votim, kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatohet që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës 'Caktimi i lokacionit për ndërtimin e deponisë së materialeve inerte në Tuqep.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori.

Abedin Kabashi- prezanton pikën e rendit të ditës 'Caktimi i lokacionit për ndërtimin e transfer deponisë.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Hajrush Shoshi.

Hajrush Shoshi- edhe këtu le të përmirësohet, le të evidentohet saktë.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtor sa të thuash këtu, Kuvendi e miraton. 30 ari janë 3000 m². Pasi që askush nuk ka diçka tjetër e hedh ne votim, kush është të miratohet kjo pikë e rendit të ditës me propozimin e drejtorit për 3000 m?

Konstatohet që nga 17 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 17 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet pika e rendit të ditës 'Caktimi i lokacionit për ndërtimin e transfer deponisë.

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetar fjala për ju Kryetar.

Kryetari i Komunës- këtu diskutime kanë edhe drejtori i Kadastrës edhe i Bujqësisë.

Agon Dreshaj- prezanton dhe sqaron ndryshimin tek drejtoria e Kadastrës në lidhje me Rregulloren.

Astrit Hajrizaj- prezanton dhe diskuton ndryshimin tek drejtoria e Bujqësisë në lidhje me Rregulloren.

Kryesuesi i Kuvendit- Niman Beqiraj e ka fjalën.

Niman Beqiraj- këto ndryshime a duhet të na vijnë në material? Nuk kemi informata të mjaftueshme.

Kryesuesi i Kuvendit- po më vjen keq po ndodhin këto probleme me email adresa.

Niman Beqiraj- tek rasti i Bujqësisë, ne e përgëzojmë largimin e shumës 5.00 euro është vendim i qëlluar.

Kryesuesi i Kuvendit- mirë, e hedh në votim, kush është që të miratohet Plotësim Ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha?

Konstatojmë që nga 19 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 19 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Plotësim Ndryshimi i Rregullores për Taksa Ngarkesa dhe Gjoha.

Shqyrtimi i pikës 7.

Kryesuesi i Kuvendit- i kemi dy vendime që i ka kthyer ministria për rishqyrtim, drejtori na jep një sqarim fjalën e ka Agon Dreshaj.

Agon Dreshaj- te rasti i B.I "TE SHIJA "D.P.T është kthyer për shkak të qarkullimeve bankare, d.m.th kur të na sjellin edhe njëherë materialin i dorëzojmë dhe ja kompletojmë dosjen ministrisë, ndërsa te rasti tjetër i 'Rina Comerc' ministria ka kërkuar ndryshimet te plani ideor të operatorit në mënyrë që të jetë i harmonizuar në tërësi me vendimin që është marrë, pra është pak a shumë e njëjta për shkak të kompletimit të dokumentacionit

Kryesuesi i Kuvendit- e hapi debatin a ka diçka? Pasi që jo, e hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 110 të datës 30.07.2024.

Shqyrtimi i pikës 8.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtori dha sqarime për të dy pikat, pasi që askush nuk ka diçka, e hedh në votim, kush është që të miratohet kjo pikë?

Konstatojmë që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 21 vota për 0 kundër dhe 0 abstenim miratohet Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 113 të datës 30.07.2024.

Shqyrtimi i pikës 9.

Kryesuesi i Kuvendit- i patëm dy propozime në hyrje, a i qëndroni atij propozimi Agron?

Agron Gashi- propozimi është i njëjtë ashtu siç e thamë në fillim, caktimi i lokacionit në qendër të qytetit për heroin Selman Kadria, sipas informacioneve familja e ka pranuar të jetë në shtëpinë e Kulturës sepse nuk ju është dhënë

mundësi tjetër, kështu që ne po e shohim të udhës që nëse është mundësia me e vendos në parkun e qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtoresha Vlora Vuthaj.

Vlora Vuthaj- Agron po ndërlidhem me këtë çështje, nuk ka qenë që nuk ju është dhënë tjetër ofertë, por ekskluzivisht është kërkesë e familjes, e them me përgjegjësi të plotë sepse kemi edhe lidhje familjare me Agron Hasanin, pra është kërkesë e familjes që lokacioni të jetë pranë shtëpisë së Kulturës. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- ekzekutivi mbetet sipas asaj që është në propozim vendim. Haki Podrimaj e ka fjalën.

Haki Podrimaj- e përgëzoj kryetarin për iniciativën, dhe masi ka pranuar familja nuk kisha dashur që këtë Kuvend ta qesim në lajthitje për lokacion. Propozoj që të tërhiqen kolegët dhe te vendoset atje është edhe muze.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Negjdet Ramaj.

Negjdet Ramaj- kam pasur kontakt me Agron Hasanaj, dhe më ka thënë që në takim me kryetarin dhe drejtorin Gencin, nuk na është lënë alternativë tjetër përveç dy propozimeve, rrethi ku shkon për Cerrcë dhe shtëpia e Kulturës, sepse ne kemi kërkuar me këmbëngulje në park të qytetit. Kërkesa e tyre ka qenë në park të qytetit. Po e qesim edhe propozimin tonë, edhe besoj që kanë me e votuar për park të qytetit sepse është vend më i dinjitetshëm, e dimë që është muzeu te shtëpia e Kulturës, prej këtij propozimi nuk tërhiqem, por nëse vjen puna me votuar edhe për propozimin tjetër ne nuk jemi kundër.

Kryesuesi i Kuvendit- ju kisha lutur që të jemi të një fjale edhe ta votojmë taman. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

Niman Beqiraj- unë nuk po dua të ndërhyj sepse nuk kam folur me familjarë, unë jam për me e votuar lokacionin të cilin e zgjedhin familjarët. E kemi edhe drejtoreshën edhe anëtarin e Kuvendit Negjdetin që japin versione të ndryshme për vendimin e familjarëve. Nëse mund ta gjejmë cili ka qenë ai vendimi i saktë ne atë kemi me e votuar.

Kryesuesi i Kuvendit- kryetarin e dëgjova në hyrje kur tha “ i autorizuari” për z. Gëzim Muriqi skulptori i njohur është pajtuar që të jetë në atë lokacion. Po kam dëshirë të jemi unik në këtë.

Negjdet Ramaj- familja e heroit Selman Kadria duan që shtatorja të vendoset në park të qytetit.

Kryesuesi i Kuvendit- drejtoresha Vlora Vuthaj e ka fjalën.

Vlora Vuthaj- Negjdet ashtu siç po komunikon ti me Agronin, të njejtën kohë jam duke komunikuar edhe unë, kërkesa zyrtare që i është bërë komunës e protokoluar është për në shtëpinë e Kulturës. Fillimisht kur më është thënë mua për në shtëpi të Kulturës, që është pjesë e drejtorisë që unë e menaxhoj fillimisht kam hezituuar, pa keqkuptime sepse Selman Kadrinë nuk e lidh asgjë me kulturën. Mirëpo pas shumë bisedimeve e takimeve, kemi ardhur në përfundim që me qenë shtëpia e Kulturës. Dhe kërkesa zyrtare e të autorizuarit të familjes ka qenë për në shtëpi të Kulturës.

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim propozimin e anëtarit të Kuvendit Negjdet Ramaj që lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit Selman Kadria të jetë në parkun e qytetit?

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 9 vota për 13 kundër dhe 3 abstenime nuk kalon propozimi i anëtarit të Kuvendit Negjdet Ramaj që lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit Selman Kadria të jetë në parkun e qytetit.

E hedh në votim propozimin e ekzekutivit që lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit Selman Kadria të jetë në shtëpinë e Kulturës?

Konstatohet që nga 24 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 24 vota për 0 kundër dhe 0 abstenime miratohet propozimi që lokacioni për vendosjen e shtatores së heroit Selman Kadria të jetë në shtëpinë e Kulturës në Istog.

Shqyrtimi i pikës 10.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Naim Behlulaj.

Faruk Kabashi nuk merr pjesë në mbledhje gjatë votimit të kësaj pike për shkak të konflikt interesit.

Naim Behlulaj- të propozuar janë Naim Sadriu zyrtar nga DKA dhe Mimoza Kabashi drejtoreshë të cilët janë të licencuar nga ministria dhe kanë kryer trajnimet e nevojshme dhe tash e katër vite janë në përzgjedhjen e drejtorëve, kërkoj nga ju që të votohet ky komision. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- e hedh në votim, kush është të formohet ky komision në bazë të propozimit të drejtorisë së Arsimit?

Konstatohet që nga 21 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 18 vota për 0 kundër dhe 3 abstenime miratohet formimi i komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve institucionet edukativo-arsimore.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës- ju kërkoj falje por krejt jashtë teme. Përshëndetje i nderuar kryetar, ne familja e Selman Kadrisë jemi të kënaqur me premtimin për ndarjen e vendit të shtëpia e Kulturës për përmendoren e heroit Selman Kadria. Sot u nderua Cerrca, Istogu, Kosova, krejt Shqiptaria, ju faleminderit shumë;- Agron Jashar Hasanaj.

Shqyrtimi i pikës 11.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Floriana Maxharraj.

Floriana Maxharraj- e kam një propozim, meqenëse po hymë në muajin tetor dhe tetori është muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit, propozoj që ndërtesat publike të komunës tonë të ndriçohen me drita rozë për të shfaqur solidaritet dhe për të promovuar ndërgjegjësimin. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- sugjerim i mirë, të gjithë jemi për atë. Fjalën e ka Lavdije Bujupaj.

Lavdiye Bujupaj- unë e kam një kërkesë që vjen nga Istogu i Poshtëm. Kërkesa ka të bëjë me ri emërtimin e një rruge në lagjen Buleshkaj, rruga në fjalë, emërohet me emrin "Faik Konica" dhe është kërkesë e banorëve të asaj ane që kjo rrugë të emërtohet me emrin "Fitim Buleshkaj" siç e dimë të gjithë që Fitimi ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ka dhënë një kontribut të çmueshëm, është kërkesë e familjarëve. Këtu i kam disa nënshkrime të banorëve që kanë shprehur gatishmëri për përkrahjen e asaj rruge. E pyes drejtorin e Urbanizimit cila është arsyeja pse është refuzuar kjo kërkesë, ndoshta është në gjendje të na tregoj.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka drejtori Dukagjin Hoxhaj.

Dukagjin Hoxhaj- ne palës vetëm i kemi kthyer përgjigje zyrtare me shkrim se pse nuk vendoset dhe ka qenë me rekomandim të Agjencionit Kadastral-Departamenti i Adresave. Ligji për Adresat specifikon qartë se si emërtohet një emër i rrugës. Aty i kemi dy kërkesa, e kemi edhe kërkesën e familjes Kurti, tani nëse i krahasojmë nënshkrimet që ti i posedon dhe që i kemi edhe ne, janë të njëjtë. Kështu që drejtoria dhe Departamenti për Adresa nuk e ka parë të arsyeshme për shkak edhe të të kaluarës së personave në fjalë, pra vdekjes së tyre. Jep sqarime të tjera.

Lavdiye Bujupaj- në bazë të disa dokumente që i posedoj, këtu është një shkresë që me 18.07.2024 mbushen 10 vite, që d.m.th plotësohet kushti për ri emërtimin e rrugës. Po thuani që personi në fjalë që nuk jeton më duhet t'i plotësoj disa

kritere, por sipas familjarëve ai ka pasur çrregullime për arsye se një kohë të gjatë ka dhënë kontribut për çlirimin e vendit. Faleminderit!

Dukagjin Hoxhaj- Ligji i Adresave e sqaron çfarë duhet të ketë një personalitet për një emërtim të rrugës e pastaj ëshë udhëzimi administrative që e parasheh se si bëhet kërkesa dhe se si shqyrtohet. Siç e ke ti vendimin e vitit 2014 e kam edhe unë këtu të vitit 2016 ku është bërë plotësim-ndryshimi i vendimit, dhe në kordinim me departamentin e adresave kanë thënë gjithmonë llogaritet vendimi i fundit.

Lavdiqe Bujupaj- ju kisha lutur për hir të familjarit që e ka bërë kërkesën me bërë një lëshim dhe me e plotësuar atë dëshirë të tyre.

Dukagjin Hoxhaj- janë dy kërkesa, i kemi krahasuar të gjitha nënshkrimet, 80-90% të nënshkrimeve janë të njejtat. Nuk isha lëshuar më shumë, i kem jep arsyet në vendim për të dy palët.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Fjolla Ukaj.

Fjolla Ukaj- e kam një pyetje nga një familje strehuese që është në komunën tonë, pyet pse çdo vit e kemi pasur një subvencion në tre mujorin e parë nga komuna dhe tani jemi në muajin e nëntë dhe nuk kemi asnjë subvencion. Pyet saktësisht a do kemi pagesë nga komuna këtë vit?

Arben Kabashi- i kemi tri familje strehuese në komunën tonë, gjashtë mujorin e parë janë përkrahur direkt nga sektori për Liri dhe të Drejta të Njeriut në kuadër të administratës në vlerë nga 200.00 euro për secilën familje, por në të njejtën kohë janë përkrahur dhe përkrahen nga drejtoria për Mirëqenie Sociale, besoj që nga fundi i tetorit do të ketë përkrahje nga drejtoria për Mirëqenie Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Fjolla Ukaj.

Fjolla Ukaj- familja në fjalë thotë që kanë ndihmë prej 100.00 euro, por jo prej 200.00 euro.

Kryesuesi i Kuvendit- fjalën e ka Arta Balaj.

Arta Balaj- e kam të qartë që buxhetin e kemi votuar por ta kemi parasysh për tjetër here. E kam një kërkesë që më ka ardhur kohëve të fundit prej Shoqatës së Verbërve, janë drejtuar tek unë për një kërkesë financiare, kjo shoqatë përbëhet nga 130 anëtarë, aktualisht çdo anëtar vet financohet për të marrë pjesë në aktivitetet e shoqatës e cila zhvillon gjithsejtë tetë aktivitete në muaj, si në qendër këtu në Istog ashtu edhe jashtë Istogut. Megjithatë për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe organizimin e aktiviteteve ata ndjejnë nevojën e domosdoshme për një kombi bus.

Arta Balaj - Jasno mi je da smo izglasali budžet, ali ćemo ga razmotriti drugi put. Imam molbu koja mi je stigla nedavno od Saveza slijepih, obratili su mi se za finansijski zahtjev, ovo udruženje broji 130 članova, trenutno je svaki član finansiran da učestvuje u aktivnostima udruženja koje razvija ukupno osam aktivnosti mesečno, kako u centru ovde u Istoku, tako i van Istoka. Međutim, da bi poboljšali učešće i organizaciju aktivnosti, oni osjećaju imperativnu potrebu za autobuskom nacijom.

